



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

PROCESVERBAL¹

(I përmbledhur)

Tiranë, më 30.12.2019, ora 13.00

Drejton mbledhjen

Ardian Dvorani – Kryetar i Këshillit

Rendi i Ditës :

1. Paraqitja e Raportit Vjetor për Veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (i përkohshëm) i zgjedhur për vitin 2019

Marrin pjesë :

- | | |
|---------------------|---------------------|
| 1. Ardian Dvorani | (kryetar) |
| 2. Vitore Tusha | (zëvendës kryetare) |
| 3. Fatjona Memçaj | (anëtare) |
| 4. Margarita Buhali | (anëtare) |
| 5. Eriol Roshi | (anëtar) |

Merr pjesë, si vëzhguese e përhershme :

1. Enio Haxhimihali, përfaqësues i Avokatit të Popullit.

Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga subjektet e treguar në nenin 233/2 të ligjit nr. 115/2016:

1. Bledar Dervishaj, përfaqësues i Presidentit të Republikës

¹ Për shkak të parashikimit shprehimisht në ligjin nr.115/2016 (neni 226 pika 1 shkronja "d", neni232 pika 2, neni 242 shkronja "c") dhe Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të KED-së (neni 17), referuar pengesës ligjore për të bërë publike qëndrimet dhe diskutimet e plota të vetë anëtarëve të KED, natyra përmbledhëse e procesverbalit, imponon që edhe diskutimet e Avokatit të Popullit dhe subjekteve të ftuara të pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur. KED, disponon materialin e plotë audio dhe te zbardhur me shkrim të çdo mbledhje, sipas ligjit.

HAPET MBLEDHJA

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, deklaroi të hapur mbledhjen.

Verifikohet prania dhe pjesëmarrja e anëtarëve të Këshillit.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani informon se anëtarja e Këshillit, zonja Arta Marku, nga njoftimet që kam pasur nuk ka qenë në detyrë këto ditë, pra vijon të jetë me pushimet e marra dhe e ka të pamundur të jetë e pranishme në mbledhje. Kuorumi për zhvillimin e mbledhjes është i vlefshëm sepse janë 5 anëtarë pjesëmarrës në këtë mbledhje.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani lexon çështjen e rendit të ditës të njoftuar paraprakisht:

Paraqitja e Raportit Vjetor për Veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (i përkohshëm) i zgjedhur për vitin 2019

Pas paraqitjes sipas rendit të ditës të raportit vjetor që përgatitet dhe publikohet sipas nenit 226 të ligjit nr.115/2016, sugjerohet të vijohet me trajtimin e procesverbaleve të përmbledhura të mbledhjeve të Këshillit të zhvilluara gjatë këtij viti.

Shtrohet për diskutim miratimi i rendit të ditës së paraqitur për këtë mbledhje të Këshillit.

Anëtarët e Këshillit nuk shprehin kundërshtime mbi rendin e ditës së programuar.

Këshilli vijon mbledhjen më çështjen e programuar të rendit të ditës.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani informon se raporti vjetor është strukturuar në formën e përmbledhjes së veprimtarisë së zhvilluar nga Këshilli gjatë vitit 2019, me një pjesë hyrëse që ka të bëjë me thelbin e asaj që është mbështetja kushtetuese dhe ligjore e veprimtarisë të këtij Këshilli, për të vijuar më tej me mënyrën se si është zgjedhur Këshilli nëpërmjet shortit dhe historiku i përbërjes së këtij Këshilli gjatë gjithë vitit. Në vijim trajtohet situata në të cilën gjëndeje Këshillit kur e ka filluar veprimtarinë e tij, veprimet, përgatitjet dhe vendimet e marra për të mundësuar atë që është ushtrimi thelbësor i kompetencave tona, pra verifikimin dhe vlerësimin e kandidaturave. Paraqiten paraprakisht çfarë masash të tjera janë marrë, përveç masave të karakterit normues, për ta bërë Këshillin të funksionojë në mënyrën më të mirë të mundshme. Më tutje trajtohet një problematikë tjetër e që është fillimi i procesit dhe si është i realizuar. Është trajtuar si një ndarje të veçantë shortimi i anëtarëve relatorë, edhe për të evidentuar faktin pse shorti u bë në mënyrë manuale dhe përse nuk mund të bëhej në formë elektronike, gjë e cila është përshkruar faktikisht edhe në të gjitha vendimet e Këshillit. Më pas, në raport trajtohen dhe përshkruhen vakancat që ka pasur për shqyrtim Këshilli në momentin që ka filluar detyrën, numrin e kandidatëve, numrin e kandidimeve, për

të vijuar me ecurinë e vendeve vakante dhe kandidaturave, vendet vakante që u përfunduan dhe ato për të cilat Këshilli vendosi rishpalljen si p.sh në rastin e Inspektorit që është kompetencë e Këshillit apo pezullimet e procedurave dhe njoftimet për vlerësim të mëtejshëm tek organet e emërtesës, pra si kanë rrjedhur këto proceduara dhe këto veprime për gjatë gjithë vitit. Në pjesën tjetër përshkruajmë vakancat që Këshilli arriti ti përfundojë dhe tia përcjellë organeve të emërtesës, si edhe evidentohen po në mënyrë të përmbledhur faktet që kanë ngelur pa u përfunduar gjatë këtij viti 3 vende vakante, dy vakanca të parakohshme ku njëra që i përket Presidetit dhe tjetra Kuvendit. Është edhe problematika e vakancave të Gjykatës së Lartë, për të cilat me gjithë rishpalljet që ka bërë Gjykata e Lartë, nuk ka mundur asnjëherë të ketë kandidatë të interesuar apo në numër minimal për këto vende vakante.

Në mënyrë të përmbledhur më pas trajtohen mbledhjet që ka bërë Këshilli, numrin e tyre. Po ashtu paraqiten disa të dhëna thelbësore, statistikore, mbi numrin e informacioneve të kërkuara dhe të ardhura, por që në fakt janë numra sepse në përbërje ato informacione janë shumë më tepër sepse në çdo përgjigje informacioni, p.sh ka më shumë sesa një informacion për kandidatë të ndryshëm apo ka disa dokumente që i bashkëlidhen informacioneve që kanë ardhur. Në raport kemi bërë përpjekje të evidentojmë edhe vështirësitë dhe problematikat që ka hasur Këshilli duke qenë një organ me kohë të pjesshme, pa buxhet, pa infrastrukturë, pa struktura të saj etj. Pra, se si e gjetëm situatën dhe si transformua deri diku, me një trend pozitiv mbështetja administrative por duke evidentuar faktin që është tërësisht e pamjaftueshme kjo edhe më faktin e proceverbaleve që trajtohen në këtë raport.

Në pjesën e fundit, në mënyrë të shkurtër parashtrohet si shqetësim që dispozitat ligjore mbi të cilat funksionon Këshilli kanë nevojë për ndryshime dhe për shtesa sepse kjo u bë e evidente qysh në fillim të veprimtarisë të këtij Këshilli, qysh në momentin që filluam procesin të përgatitjes së akteve nënligjore. Konstatuam jo pak çështje të cilat nuk ishin të rregulluara në mënyrë të qartë në ligj. Apo ndërmjet dy apo tre ligjeve të cilat janë të zbatueshme për ne ka edhe rregullime të cilat nuk them që janë të kundërta por aty trajtohen me një gjuhë dhe me një mënyrë disi të ndryshme nga njëra-tjera. Ka nevojë që Kuvendi të ndërhyjë dhe të bëjë ndryshime si në ligjin nr. 115/ 2016 “ Për organet e qeverisjes të sistemit të Drejtësisë” përfshirë dhe pjesën tonë, ashtu dhe në ligjin “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”.

Për sa i përket mbështjetes administrative thjesht evidentojmë që minimalisht do të duhen të paktën edhe 2 specialiste të sekretarisë gjyqësorë për tu bashkuar në mënyrë të dedikuar Këshillit për vitin e ardhshëm. Gjithsesi kjo është një çështje që duhet ta trajtojë

Këshilli për vitin e ardhshëm. Ndërkohë janë u zhvilluar të gjitha përpjekjet e mundshme me Këshillin e Lartë Gjyqësor, por edhe me mbështetjen e Delegacionit Evropian dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për të rishikuar çështjet e administrimit me të gjithë problematikat që ka Gjykata e Lartë sidomos në kuadrin e emergjencës dhe besojmë që Gjykata e Lartë për vitin e ardhshëm, shpresojmë sa më shpejt edhe gjatë Janarit, do të gjejë një mbështetje për të pasur shtesa në buxhet, shtesa në organike, e kështu me radhë. Së pari, për të përballuar problemet që ka Gjykata e Lartë, por meqenëse jemi në këtë mbledhje, ajo reflektohet pashmangshmërisht edhe në mbështetje me personel administrativ dhe pjesa tjetër mbështetëse të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani i sugjeron anëtarëve të Këshillit të shprehin mendime në lidhje me përmbajtjen e raportit.

Anëtarët e Këshillit diskutojnë dhe parashtrojnë mendime dhe sugjerime rreth përmbajtjes së raportit vjetor. Në thelb, dakodësohet që raporti i paraqitur është një sintezë dhe përmbledhje faktike e veprimtarisë që ka kryer Këshilli gjatë vitit 2019 nga momenti i konstituimit, përgatitjes, diskutimit dhe miratimit të akteve nënligjore, fillimit dhe realizimit hap pas hapi të procedurave të verifikimit të të gjitha vendeve vakante, të procedurave të vlerësimit të realizuara me kandidatët e lejuar në vendet vakante deri në dërgimin e listave përfundimtare për pese nga këto vende vakante organeve të emërtesës, Presidentit të Republikës dhe Kuvendit.

Po kështu raporti përmban përmbledhjen e sfidave dhe vështirësive objektive me të cilat është përballur Këshilli në përmbushjen e detyrave të tij, përfshirë ato të natyrës administrative dhe të mbështetjes së veprimtarisë së Këshillit. Njëkohësisht në raport duhet të saktësohen disa nga të dhënat që lidhen me përbërjen e Këshillit dhe të dhënat lidhur me disa çështje të ecurisë së shqyrtimit të vakancave nga ky Këshill.

Gjithashtu, nga përvoja e kësaj veprimtarie të Këshillit përgjatë viti 2019 rezulton që legjislacioni ka nevojë për shtesa dhe ndryshime, për të trajtuar më qartë dhe në mënyrë më të plotë në nivel ligji problemet me të cilat u ndeshëm duke filluar nga momenti i përgatitjes së akteve nënligjore dhe më tej në proceset e zbatimit të procedurave të verifikimit dhe të vlerësimit të kandidaturave.

Sikurse ka edhe dispozita të paqarta apo që mund të pengojnë ose bien ndesh me njëra-tjetrën. Garancia thelbësore është fakti që mbledhjet regjistrohen në sistemin audio dhe nevojitet të rishikohen rregullat duke pasur parasysh njëkohësisht natyrën e mbyllur të mbledhjes dhe transparencën, natyrën dhe qëllimin e pjesëmarrjeve në mbledhjet e Këshillit,

çështjet e transkriptit, procesverbalit, nevojës së procesverbalit të përmbledhur dhe të përmbajtjes që duhet pasqyruar në këtë lloj procesverbali etj..

Gjithashtu ka nevojë të plotësohen në ligj dispozitat lidhur me kompetencat e Këshillit për të kryer procedurat e verifikimit të pasurisë dhe të integritetit në mënyrë që ky Këshill realisht apo pa pengesa të bëjë verifikimin e kandidatëve.

Mund të diskutohen edhe përcaktime të nevojshme në ligj lidhur me paraqitjen e kandidimeve të njëkohshme të të njëjtit kandidat në vende të ndryshme vakante, si edhe rasti i parashikuar për përgatitjen e dy listave me kandidatë nga radhët e gjyqësorit dhe atyre me juristë të tjerë kur ka më shumë se një vend vakant përpara të njëjtit organ emërtesë etj.

Enio Haxhimihali pas diskutimeve të anëtarëve të Këshillit, merr fjalën dhe shprehet se Institucioni ynë ashtu si dhe më parë e ka vlerësuar maksimalisht ngarkesën që ka pasur ky Këshill gjatë vitit 2019 sepse i ra barra, për ato arsye që ne i kemi thënë në raportet tona të shortit të 2017-ës, 2018-ës, që të hartonte bazën ligjore të funksionimit. Pra në një farë mënyre hodhi themelet e punës së Këshillit me miratimin e rregulloreve. Dhe kjo ishte një punë e madhe që u bë nga Këshilli por njëkohësisht dhe nga stafi ndihmës, i cili, siç dhe ju përmendët, ka qënë i reduktuar për vet mënyrën se si u hartua ligji.

Për sa i përket raportit konkret, fatkeqësisht ne e kemi të pamundur të japim një përgjigje sot për vet kohën e shkurtër që u dërgua raporti, por rezervojmë të drejtën që, fatkeqësisht jo këtij Këshilli, por Këshillit tjetër, për t'ja dhënë mendimin tonë me shkrim. Biles ne, siç mund të jeni në dijeni, në muajin nëntor botuam një raport paraprak sepse ne mendojmë të bëjmë një raport të veçantë, gjë që sigurisht kërkon kohën e nevojshme, sepse përveç punës së mirë, njëkohësisht, gjatë veprimtarisë së Këshillit kemi konstatuar edhe problematika të caktuara që ua kemi bërë me dije. Ndaj mendojmë që ka nevojë për arsyetim, për argumentim, për parashtrimin si duhet të tyre, pra qoftë për rekomandime legislative apo për mënyrën se si është zbatuar ligji, në mënyrën, gjithmonë në vlerësimin tonë, jo të duhur nga KED-ja në raste të caktuara. Kështu që rezervojmë të drejtën për të dhënë një opinion më të plotë në një kohë të dytë.

Bledar Dervishaj merr fjalën dhe shprehet se faktikisht nuk është se ka qënë një kohë e gjatë apo një kohë e mjaftueshme që të shqyrtojmë edhe raportin por edhe dokumenta të tjera të përcjella të shtunën dhe ditën e sotme. Me thënë të drejtën, ndoshta për këtë raport do të kisha edhe më shumë mundësi kohë për tu shprehur nëse do të kishte një kohë pak më të gjatë sepse raporti, në disa momente, për aq sa unë kam mundur të vlerësoj ditën e sotme apo ditën e shtunë, në disa momente del përtej vlerësimit të Këshillit ose kompetencave të Këshillit, në disa momente të tjera është më i ngushtë ose më i rrudhur seç duhet të ishte, aty

ku ka pasur problematikë përgjatë veprimtarisë. Nëqoftëse me lejoni, do të cek në çdo faqe për secilën nga termat për aq sa unë kam konstatuar gjithmonë deri më tani.

Në faqen 2 (dy) ku flitet për funksionimin e këtij Këshilli përgjatë gjithë vitit dhe jo të 2 (dy) Këshillave të tjerë, unë do të sugjeroja, ju e vlerësoni vet, që fjalitë arsyetuese që “*u shkarkuan nga vettingu*” apo “*ata që u konfirmuan*”, lë të kuptosh sikur ky Këshill i 2018-ës nuk ka funksionuar për shkak të kuorumit që mund të ketë humbur, për shkak të shkarkimit nga detyra të disa anëtarëve të tij. Ndërkohë që kuorumi ka ekzistuar deri më tetor 2018. Kështu që, mund të thuhet shumë në mënyrë konstatuese që nuk kanë funksionuar të dy Këshillat përveçse një mbledhje në datën 19 (nëntëmbëdhjetë) dhe më tej ky Këshill nuk është mbledhur më.

Një koment tjetër, pavarësisht se kjo është në procesverbalin e zgjedhjes së këtij Këshilli nga Kuvendi, ky Këshill nuk është i përkohshëm sepse mandatin e tij e ka pasur të plotë, përkohshmëria ka qënë për Këshillin e vitit 2016. Për atë Këshill, që duhej të zgjidhej në momentin që hyn në fuqi ndryshimet kushtetuese. Ky Këshill në vlerësimin tonë është Këshill i Emërimeve në Drejtësi. Mekanizmi i vjetër i përdorur duke marrë kandidatura nga institucionet me një dispozite kalimtare nuk e bëjnë të përkohshëm. Ky Këshill ka funksionuar për 12 (dymbëdhjetë) muaj, kështu që nuk mund të konsiderohet i përkohshëm. Megjithatë, nëqoftëse proces-verbali i Kuvendit i zgjedhjes e ka kështu...

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani ndërhyr dhe shprehet se aty është marrë.

Bledar Dervishaj merr fjalën dhe vijon të shprehet se e kuptoj, por i përkohshëm nuk mund të quhet. Një koment tjetër që do doja të vendosej, ka të bëjë edhe me mënyrën sesi trajtohet anëtarësia e Këshillit dhe humbja e mandatit prej anëtarëve për shkak të shkarkimit nga vettingu të këtij Këshilli, ku mbyllet me zotin Fatri Islamaj fjalia këtu që është shkarkuar më datën 10 dhjetor. Po ashtu mund të evidentohet në këtë pjesë edhe që anëtarja tjetër Arta Marku ka humbur funksionin bazë mbi të cilin u zgjodh. Të jetë e shkruajtur aty, sepse unë nuk i di arsyet. Mospjesmarrja në mbledhje është shkak disiplinor. O nuk ka ardhur se e ndjen veten që e ka humbur këtë funksion ose ka një shkak tjetër të konfirmuar por duhet thënë diçka. Me vendimin nr. 138, dt. 05.12.2019 është zgjedhur Z. Olsion Çela Prokuror i Përgjithëm, pra zonja Marku ka humbur këtë funksionin që ka mbi të cilin është zgjedhur. Mendoj që duhet të gjej vend patjetër në këtë pjesë.

Në faqen 6 (gjashtë) ka vlerësime mbi numrin e këshilltarëve, numrin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë. A është kjo një funksion që duhet ta kryej Këshilli? A është ky një funksion i Kryetarit apo një funksion i Këshillit? Që të arsyetoj në raport numrin e kufizuar dhe ngarkesën e punës në Gjykatën e Lartë. Duhet patur në vëmendje nga Këshilli edhe kjo

çështje sepse lidhet më pas me arsyetimin e moszbardhjes së procesverbaleve në kohë. Duket sikur kjo çështje apo Këshilli në këtë raport përfundimtar, po legjitimon në njëfarë mënyre pse procesverbalet nuk u zbardhën në kohë, sepse nuk kishte sekretari teknike apo nuk kishte staf të mjaftueshëm. Unë nuk besoj që është Këshilli ai që duhet ta jap këtë koment, por është e atij që ligji ja ka ngarkuar për detyrë, Kryetarit të Këshillit. Pra, mund të jetë si koment i Kryetarit por jo si koment i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Një saktësim tjetër në faqen 9 (nëntë), në qoftë se do e vlerësoj Këshilli gjithmonë. Kur flitet për vendet vakante për të cilat ky Këshill është marrë, mendoj që për çdo vend vakant ku thuhet vendi vakant, vakancë e plotë në Gjykatën Kushtetuese i shpallur nga Presidenti në datën 7 (shtatë), mund të vihet data sqaruese e ish-gjyqtarit Sokol Berberi, për të qënë më të qartë ai publiku i jashtëm që do të jetë konsumatori i këtij raporti.

Një çështje tjetër që mund të gjente më shumë trajtim, është edhe fakti i vakancave që i takonin për shpallje edhe aplikim Gjykatës së Lartë. Mund të jetë edhe pak më shteruese informacioni që jepet në këtë raport. Çfarë komunikimesh ka pasur Këshilli me Gjykatën e Lartë, a i ka rishpallur Gjykata e Lartë dhe e ka njoftuar Këshillin, sepse flasim për 3 (tre) vakanca që Gjykata e Lartë duhet të kishte rishpallur dhe mund të kishim dhënë më shumë produkt apo brumë për të punuar nga ky Këshill.

Në faqen 11 (njëmbëdhjetë), një koment tjetër jepet për vakancën që i takon Presidentit të Republikës, flas për vakancën që është lënë bosh nga ish-gjyqtari Besnik Imeraj, ku jepet një fakt konstatues që Këshilli është në fazën e tyre përmbyllëse dhe thuajse të gatshme për të shqyrtuar pjesën më të madhe të kandidaturave në mbledhjen e Këshillit. Mendoj se kjo duhet të kishte edhe pak më shumë sqarim, të themi se çfarë faze është shqyrtimi i kësaj vakance dhe përse Këshilli nuk mundi që ta përmbyllte vlerësimin dhe verifikimin edhe të kandidatëve që konkurojnë aty.

Një koment tjetër në faqen 12 (dymbëdhjetë) ka të bëjë me një vlerësim që bëjmë në raport, ku thuhet që kandidatë të ndryshëm u dorëhoqën dhe u konstatua edhe mosnjohja e ligjit prej tyre dhe kjo lidhet me shkakun e dorëheqjes. Unë mendoj se Këshilli nuk mund të bëjë këtë konstatim, mund të thotë vetëm që u tërhoqën nga kandidimi por jo ta lidhë që arsyeja është mosnjohja e ligjit nga kandidatët.

Edhe një vlerësim tjetër, përsa i takon kandidimit në më shumë se një vakancë. Këtu është një paragraf, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, unë po e citoj siç është *“Veprimtaria ka hasur edhe një numër të madh kandidatësh të cilët janë kandiduar njëkohësisht në më shumë se një vend vakant”* dhe vazhdon fjalia *“gjë e cila është një e drejtë e tyre përderisa ligji nuk përcakton ndonjë kufizim”*. Ky vlerësim a do të duhej të ishte këtu? KED-ja mund ta

konstatoj si fakt patjetër, se shumë kandidatë kanë aplikuar. Është një e drejtë e tyre e shfrytëzuar? Ata e kanë bërë fakt, dhe unë mendoj se nuk ka vend të jetë.

Në faqen 15 (pesëmbëdhjetë), përmenden të gjitha vakancat, pra mbledhja e datës 21 shtator, unë mendoj që përpara fjalëve, pra ku kemi pikën 1, 2, 3, 4 ku është renditja e kandidatëve për secilën vakancë, të shtohen togfjalëshet e vendimeve përkatëse. Pra me vendimin 128 dhe 129, janë miratuar raporti i arsyetuar dhe lista përfundimtare për vakancën e shpallur nga Presidenti dhe kjo gjë të vazhdoj 130, 131, 132, 133, 134, 135 për të katërta pikat, sipas vendimmarrjes së Këshillit normalisht.

Kemi edhe një koment tjetër në faqen 15 (pesëmbëdhjetë) “*lista përfundimtare të renditjes së kandidatëve raportet e arsyetuara për renditjen e tyre janë dërguar...*”. Të saktësohet se janë dërguar prej Kryetarit të KED-së 2 (dy) organeve të emërtesës dhe mbyllet fjalia, në datën 8 tetor dhe 14 tetor. Këtu unë mendoj se ka vend të shtohet dhe çfarë ka ndodhur sepse duhet thënë që pas dërgimit të listave të Kryetarit ka një komunikim shkresor të Presidentit me Kryetarin dhe me Këshillin, ka dhe një mbledhje të datës 7 (shtatë).

Për sa i takon pjesës përmblylëse ku jepen arsyetimi apo vlerësime se përse nuk u bë e mundur përmbushja e një detyrimi ligjor, po flasim gjithmonë për procesverbalet, për zbardhjen e tyre, unë mendoj që nuk është atribut i Këshillit për të thënë që Gjykata e Lartë ka numër të vogël punonjësish apo nuk ju vunë në dispozicion Këshillit. Ky është një atribut apo koment që mund ta bëj Kryetari por jo Këshilli.

Ndërsa për sa i përket ndryshimeve ligjore, unë mendoj që Këshilli duhet të jetë më i qartë në lidhje me problematikat. Nëqoftëse ka probleme të ligjit, të përplasjes së ligjit apo të konkurimit të normave midis Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, Ligjit për KED-në, organet kolegjiale apo ky Këshill ka ndeshur si problematikë nga aplikimi i tyre, do duhet të thuhet tamam dispozita që ti referohet Kuvendit për ndryshim. Sepse Kuvendi referuar nga një qëllim i mirë i Këshillit për të riparuar dispozitat, mund ti marrë apriori edhe të bëj ndryshime të natyrave nga më të ndryshmet siç publikisht i ka bërë me dije se do ti bëj. Një sugjerim që mund të bënim është, se ky Këshill sot është me 5 (pesë) veta dhe për shkaqe të mbarimit të mandatit të anëtarëve të tjerë mund të ishin plotësuar dhe anëtarët kryesor të Këshillit nëse ligjit do ta parashikonte që nëse një anëtar humbet statusin e magjistratit apo shkarkohet nga detyra, organi hedh shortin. Pra një qëllimi i mirë mund të shkruhet kështu. Ky është një nga problemet e ligjit. Por nëse do të themi që ka probleme në dispozitë duhet ti themi se cilat janë problemet dhe ku të sugjerohet Kuvendi që të ndërhyjë, pra çështjen, problematikën konkrete.

Edhe një çështje të fundit për këtë raport, përsa i përket procesverbaleve në lidhje me përgjigjen që ne si institucion kishim marrë nga kryetari KED-së edhe ne kemi bërë një përgjigje sot me shkrim, duhet të jetë administruar, në të cilën për procesverbalet e dërguara....

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani ndërhyt dhe shprehet se kjo shkresë sapo erdhi.

Bledar Dervishaj merr fjalën dhe vijon të shprehet se për procesverbalet e dërguara nuk mund të japim koment përderisa nuk na u ofruan transkriptet e plota të zbardhura apo audio-t e tyre.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani merr fjalën dhe sqaron se disa nga ato që ju thatë bëhen sepse nuk ka ndonjë problem. Por një gjë dua të them, për zonjën Marku. Është apo nuk është anëtare e Këshillit, kjo nuk është çështje e trajtimit në raportin vjetor. Ju thoni që është zgjedhur e tillë, dhe ajo nuk është më Prokurore e Përgjithshme dhe ndaj nuk është këtu.....

Bledar Dervishaj ndërhyt dhe shprehet se I nderuar unë nuk thash atë. Por në raport duhet të gjej vend fakti që anëtarja e Këshillit humbi funksionin bazë mbi bazën e të cilit u zgjodh.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani merr fjalën dhe vijon të sqarojë se ky që shprehni është një mendim, një qëndrim dhe ne nuk kemi qëndrim për këtë. Dhe pastaj ky është një diskutim tjetër, e ka humbur apo s'e ka humbur. Ju folët për natyrën e raportit dhe thatë në disa vende ka dalë nga natyra e vet disa herë. Unë them që kjo është një gjë që del nga natyra e raportit sepse ky nuk është konstatim. Ky është raporti vjetor dhe shpjegon çfarë ka ndodhur. Ne nuk mund të marrim përsipër të themi që anëtari ka humbur mandatin sepse nuk na takon ne ta themi këtë në raport. Ajo që thatë juve atë nënkupton se nuk ka çfarë të nënkuptojë tjetër....

Bledar Dervishaj ndërhyt dhe shprehet se por nëqoftëse e ka humbur mandatin, dikush nga organet do të duhet ta deklarojë atë apo jo? Që e ka humbur mandatin. Unë prandaj nuk e thashë kot. E thashë që kjo çështje duhet të gjejë pasqyrim në Këshill sepse lidhet me procesin disiplinor ndaj këtij anëtari të Këshillit, mbi një mungesë të justifikuar apo një mungesë të pajustificuar. Është pjesë e raportit sepse flitet për Fatri Islamaj që është shkarkuar edhe kjo nuk ka ardhur, sepse jo të gjithë kanë ardhur në mbledhjen e Këshillit ashtu siç përmendet në raport.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani merr fjalën dhe vijon të sqarojë se ne po bëjmë raportin vjetor të veprimtarisë së Këshillit dhe parashtrijmë vetëm se çfarë ka ndodhur. Që kolegu jonë z. Fatri u shkarkua, për këtë ka një vendim që sipas Kushtetutës e ka marrë një

organ tjetër dhe sigurisht që ky është një fakt. Ndërsa e ka humbur apo nuk e ka humbur mandatin një anëtar ky nuk është fakt, ky është një mendim dhe ne nuk e dimë e ta themi këtë gjë tani sepse ne nuk jemi mbledhur për këtë çështje. Ne duhet të bëjmë një mbledhje për këtë, nëse na takon ne ta trajtojmë.

Ndërsa për shumë nga sugjerimet e tjera të bëra në mbledhje ne mund ta plotësojmë raportin, p.sh lidhur me të dhënat e vakancave të ish-gjyqtarëve. Po kështu në raport mund ti bëjmë pak më konkrete sugjerimet për ndryshime në ligj, për natyrën e dhomës së mbyllur, dokumentimin e mbledhjes, procedurat verifikimit, listat magistrat jo magistrat etj.

Edhe të dhënat për vakancat që janë shpallur, shpallen dhe plotësohen nga Gjykata e Lartë mund të plotësohen, pastaj më tej është çështje deliakte edhe për të ardhmen se çfarë mund të bënte dhe të bëjë Këshilli nëse do të kishte pasur kandidatura, nëse i përmbyll procedurat e verifikimit dhe vlerësimit. Ta dërgojë listën e kandidatëve të renditur Gjykatës së Lartë e cila nuk funksionon dhe nuk mund të zgjedhë gjyqtarin e Gjykatës Kushtetuese? A do të quhej i zgjedhur ai që ishte renditur i pari nga KED etj.?

Mosnjohjen e ligjit nga kandidatët edhe mund ta heqim. Por është një e vërtetë. Është një e vërtetë që ne që i prekëm kandidaturat këtë e kuptuam dhe kjo ishte shumë e evidente. Disa nga kandidatët gjatë procesit e shfaqën vetë habinë dhe u gjendëm para një situatë që nuk e kuptonin se çfarë afatesh dhe kushtet duhet të përmbushnin, ishin të papërgatitur për këtë proces madje disa prej tyre i humbën edhe afatet.

Komunikimin me Presidentin për vakancat e përfshijmë në raport. Zoti Bledar ju kërkoni të veçoni Kryetarin nga Këshilli e të shënohet fakti që shkresat për vendet vakante tek Presidenti dhe Kuvendi i ka bërë kryetari i Këshillit. Po kryetari i KED do ti përcjellë sepse çdo komunikim me palët e treta dhe çfarëdo shkresë që del nga KED për të tretët përfshirë edhe organet e emërtesës përcillet dhe firmoset vetëm nga kryetari dhe nuk ka arsye se përse vetëm për atë rast duhet të përmendet që e ka përcjellë kryetari.

Nuk ka asnjë arsye të mos përmendet edhe problematika që ka Gjykata e Lartë. Kjo duhet të gjej pasqyrim sepse ne e kemi analizuar e diskutuar se kush është gjendja. Në qoftë se ju doni që të mbulojmë arsyet se pse kemi ndeshur problematika. Kjo është një arsye. Ju mund të pretendoni vetë çdo gjë tjetër paaftësinë etj. etj.. Por kjo problematikë është fakt. Unë jam në një detyrë të dyfishtë dhe e di fare mire se sa problema ka Gjykata e Lartë që ti sigurojë mbështetjen KED-it. Atë që përcakton ligji Gjykata e Lartë nuk ka qenë në gjendje ta japë dhe jo sepse nuk ka dashur.

Për të ardhmen, gjë e cila do të diskutohet me Këshillin e ri vitin tjetër, Këshillit nuk i nevojiten më shumë këshilltarë sepse nuk kemi pasur probleme. Aty ku kemi pasur probleme

është pjesa tjetër e mbështetjes administrative, ndaj edhe duhen minimalisht dy specialiste në sekretari dhe që të bëhen pesë ose gjashtë gjithsej.

Enio Haxhimihali merr fjalën dhe shprehet se për shortin elektronik ka nevojë për mbështetje sespe nuk realizohet dhe duhet parashikuara masa për vitin 2020.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani merr fjalën dhe vijon të sqarojë se në mbledhjet e vitit 2020 do të trajtohet edhe kjo çështje bashkë me të tjerat. Por shorti elektronik nuk zgjidhet dot tani, ndoshta as edhe për dy vjet. Jemi duke punuar ndërkohë me sistemin elektronik të Gjykatës së Lartë, nuk po hyj në detaje pse ka shumë probleme sistemi.

Do të jetë shumë sfidues edhe viti tjetër sepse duket sikur jemi shumë komod tani në Dhjetor, meqenëse na ka rënë disi ngarkesa në Gjykatën Lartë dhe prandaj i përdorëm të gjitha sekretaret që i punuan dhe zbardhën procesverbalet. Por, mendohet se në fund të Janarit ngarkesa e Gjykatës së Lartë do të fillojë të marrë rritje sepse po erdhën tre gjyqtarët unë mund tju them se këtu janë 2-3 mijë dosje gati për tu trajtuar dhe fillon një zinxhir tjetër pune, i cili do të ngarkoj edhe këshilltarët që kemi. Edhe ky është një problem tjetër. Po do të ngarkoj sekretarinë dhe shpresoj që K.L.Gj-ja të miratojë mbështjetjen që kemi kërkuar së bashku me institucionet ndërkombëtare që na asistojnë, për një rritje urgjente të organikës së Gjykatës së Lartë. Kjo sepse me 7 punonjëse sekretarie në total që kemi në këtu, nuk është përballuar sa duhet ngarkesa aktuale edhe pa gjyqtar, por mendoni kur të bëhet punë e dedikuar mbi normën e zakonshme të punës së një gjyqtari për të trajtuar dosjet. Po kështu njerëzit paguhen dhe ky është një problem tjetër buxhetor që zgjidhet. Mund të adresojmë edhe ligjvënësin por është e parashikuar në Kushtetutë që KED është me kohë të pjesshme. Në qoftë se Këshilli ka shumë ngarkesë dhe në qoftë se Gjykata e Lartë po ashtu ka shumë ngarkesë apo ka kufizime organike dhe personeli, kjo bëhet menjëherë problem. Është menduar që nuk do të kishim shumë ngarkesë tek Këshilli, është menduar edhe se Gjykata e Lartë do të ishte me zyra plotë dhe jo me zyra bosh siç është tani, jo vetëm të gjyqtarve por kemi dhe në zyrat e sekretarisë më pak njerëz për shumë arsye. Tani kemi një projekt bashkëpunimi me Euralius dhe Justice For All, posaçërisht për Gjykatën e Lartë, jemi duke punuar intensivisht. Po adresohen urgjentisht edhe ca çështje të IT-së, por nuk mund të ndryshohet tani në tërësi sistemi. Mund të ëëjmë disa ndërhyrje për të modifikuar pak programet me problemet që ka vetë Gjykata e Lartë, por për modifikime lidhur me shortin e KED as që nuk mund të bëhet fjalë për modifikime.

Nuk e dimë nëse dhe kur mund të reagojë ligjvënësi, por besoj që nuk do të jetë më kjo situatë me procesverbalet sepse për ne është vërtetë një problem administrimi. Ndërkohë më vjen shumë keq të harrojmë se sa shumë dhe se çfarë kemi bërë gjatë gjithë këtij vitë. Ne

nuk jemi mbledhur në KED vetëm për procesverbale, sigurisht ajo është një gjë shumë e rëndësishme, por kemi bërë një punë të tillë që nuk e dimë se si do të mund ta bënte një përbërje tjetër e Këshillit. Nuk mund as të mendohej kur filloi veprimtaria e KED se do të kishte aq shumë ngarkesë dhe atë trafik të jashtëzakonshëm informacioni dhe përpunimi të tij etj., ngarkesë që normalisht, një institucion “ **ad hoc**”, nuk e përballon dot. Jo rastësisht janë bërë gati 40 mbledhje dhe me orë të gjata, mesatarisht mbi 2 orë e 40 minuta.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani merr fjalën dhe sugjeron vijimin e mbledhjes me trajtimin e çështjes së miratimit të procesverbaleve të përmbledhur. Më shumë vështirësi gjatë këtyre javëve të fundit dhe deri në këto momente të fundit ne mundëm të përfundojmë proceset e zbardhjes së mbledhjeve të Këshillit dhe të përgatisim edhe procesverbalet e përmbledhur, për të cilat edhe vetë më është dashur ti verifikoj madje edhe ti dëgjoj me kujdes. Në procesverbalet e përmbledhur, për sa i përket pjesës së fjalëve të pjesëmarrësve joanëtarë në mbledhje ato janë praktikisht të plota, me përjashtim të fjalëve të tepërta dhe disa shprehjeve parazitare që nuk cenojnë aspak mendimin dhe qëndrimin e shfaqur sepse kjo pjesë nuk diskutohet që është e pasqyruar.

Problem ka qenë dhe mbetet përgatitja e përmbledhjes së procesverbalit kur kemi lejuar të tejzakohen rregullat që kemi miratuar dhe disiplinën në radhën e të folurit, apo kemi lejuar ndërhyrje të herpashershme në diskutime të njëri-tjetrit. Duke pasur parasysh edhe që sipas ligjt nuk pasqyrohen në detaje diskutimet e anëtarëve por vetëm qëndrimet dhe votimet e tyre, ku edhe nuk është e lehtë të ndahet e dallohet se ku anëtari diskuton apo ku ai/ajo mban qëndrime. Është bërë kujdes që diskutimet të mos reflektohen në tekst por njëkohësisht të pasqyrohet të gjitha qëndrimet e përbashkëta, çështjet e diskutuara, votimi dhe mënyra se si kemi votuar. Nga ana tjetër, duket sikur kanë folur dhe diskutuar shumë më tepër të tjerët jo anëtarë se sa vetë anëtarët e Këshillit. Aq më tepër që kemi lejuar të flitet dukshëm më shumë se sa minutazhi i përcaktuar në rregullore dhe më shumë se sa një herë për secilën çështje. Atëherë nga kjo si pasojë vijnë e krijohen probleme të tjera në përgatitjen dhe natyrën e përmbledhjes së procesverbalit. Ndoshta me ndryshime në ligj mund të rregullohet disi ky problem duke ndërhyrë dhe qartësuar problematikën e mbledhjes së Këshillit. Nuk ka qenë zgjedhje e këtij Këshilli kufizimi i pasqyrimin dhe publikimit të diskutimeve të anëtarëve. Ndërsa për shortin kemi hartuar dhe mbatjur procesverbal të plotë më vete, krahas pasqyrimin të veprimit në procesverbalin e përmbledhur të mbledhjes.

Anëtarët e Këshillit diskutojnë lidhur me procesverbalet e përmbledhur të paraqitur për trajtim, si edhe për problematikën ligjore që lidhet me pasqyrimin në këto procesverbale të diskutimeve të anëtarëve të Këshillit e që i vendos anëtarët në një situatë jo të lehtë për

pasqyrimin e veprimtarisë së tyre, dakordësohen me publikimin e procesverbaleve të përmbledhur, si edhe që, nëpërmjet nismave ligjvënëse, mund të gjendet mënyra që të adresohet më qartë natyra e procesverbaleve, e rasteve dhe mënyrës së publikimit të tyre etj., aq më tepër në kushtet kur Këshilli vendimet e tij i ka të arsyetuara në mënyrë të hollësishme lidhur me motivet dhe arsyet e vendimmarrjes, përfshirë edhe arsyetimet e anëtarëve që kanë pasur mendim dhe qëndrim ndryshe për vendimmarrjen. Ndërsa për publikimin e procesverbalit të përmbledhur të kësaj mbledhje të fundit, në kushtet kur ky Këshill e përfundon sot mandatin e tij, komunikiminparaprak për të verifikuar saktësinë e tij do të realizuar nëpërmjet komunikimit elektronik me pjesëmarrësist në mbledhje.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani deklaron të mbyllur mbledhjen

MBYLLET MBLEDHJA NË ORËN 14.50

SEKRETARE

KRYETAR

Ermelinda KADIU

Ardian DVORANI

Dorina DULAJ